

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-161

PRAJMER EPOKSID, LLAÇ PËR NIVELIME, SHTRESË E NDËRMJETME DHE LLAÇ PËR SHTRIME



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor®-161 është rrëshirë epokside me 2 përbërës, me viskozitet të ulët dhe për shumë përdorime, e cila mund të përdoret si prajmer epoksid, llaç për nivelime, shtresë e ndërmjetme dhe llaç për shtrime. Përdorim i brendshëm dhe i jashtëm.

PËRDORIMET

Sikafloor®-161 duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

- Për lyerjen me prajmer të nënshtresave të betonit, llaçeve të çimentos dhe llaçeve epokside
- Për nënshtresa me absorbueshmëri të ulët deri në mesatare
- Prajmer për sistemet e dyshemesë ekonomike Sikafloor-263 SL N dhe Sikafloor-264 N
- Përzierje për llaçet niveluese dhe shtresat e ndërmjetme të llaçit
- Shtresë e ndërmjetme poshtë Sikafloor-263 SL N dhe Sikafloor-264 N

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Viskozitet i ulët
- Depërtim i mirë
- Rezistencë e mirë ngjitjeje
- Kohë të shkurtëra pritjeje
- Për shumë përdorime

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Pajtueshmëri me LEED v4 EQc 2: Materiale me çlirime të ulëta

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 1504-2 - Produkt për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit - Veshje
- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 13813 - Llaç rrëshirë për dysheme për përdorim të brendshëm në ndërtesa
- Pajtueshmëria e veshjes DIN EN 13578, Sikafloor®-161 / -264, Polymer Institut, Raport testimi nr. P 6239

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Epoksid	
Ambalazhi	Përbërësi A	kovë 23,7 kg
	Përbërësi B	kovë 6,3 kg
	Përbërësit A+B	ambalazh 30 kg gati për përzierje
Paraqitja / Ngjyra	Përbërësi A	lëng, kafe-transparent
	Përbërësi B	lëng, transparent
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet i pahapur dhe i padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5 °C dhe +30 °C. Lexoni gjithmonë ambalazhin.	

Dendësia	Përbërësi A	~1,6 kg/l	(DIN EN ISO 2811-1)
	Përbërësi B	~1,0 kg/l	
	Rrëshira e përzierë	~1,4 kg/l	

Të gjitha vlerat e dendësisë në +23 °C

Përmbajtja e substancave të ngurta për ~100 %
peshë

Përmbajtja e substancave të ngurta për ~100 %
vëllim

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore D ~76 (7 ditë / +23 °C) (DIN 53 505)

Rezistenca ndaj ngjeshjes > 45 N/mm² (Ilaç shtrimi, 28ditë / +23°C / 50 % lagështi relative) (EN13892-2)
Llaç shtrimi: Sikafloor®-161 i përzierë 1:10 me Sikafloor®-280 filler

Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje ~15 N/mm² (Ilaç shtrimi, 28ditë / +23°C / 50 % lagështi relative) (EN13892-2)

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje > 1.5 N/mm² (dështim betoni) (ISO 4624)

Rezistenca termike

Ekspozimi*

Nxehtësi e thatë

I përhershëm

+50 °C

Afatshkurtër max. 7 ditë

+80 °C

Afatshkurtër max. 12 orë

+100 °C

Rezistencë afatshkurtër ndaj lagësisë/nxehtësisë së njomë* deri në +80°C ku ekspozimi është vetëm rastësor (pastrim me avull etj.).

*Pa ekspozim të vazhdueshëm kimik & mekanik dhe vetëm në kombinim me sistemet Sikafloor® si sistem me spërkatje me trashësi ~3-4 mm.

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Sistemet	Prajmer	
	Beton me porozitet të ulët / mesatar	1–2 × Sikafloor®-161
	Llaç nivelues i imët (ashpërsi sipërfaqeje < 1 mm)	
	Prajmer	1–2 × Sikafloor®-161
	Llaç nivelues	1 × Sikafloor®-161 + rërë kuarci (0,1–0,3 mm)
	Llaç nivelues mesatar (ashpërsi sipërfaqeje deri në 2 mm)	
	Prajmer	1–2 × Sikafloor®-161
	Llaç nivelues	1 × Sikafloor®-161 + rërë kuarci (0,1–0,3 mm)
	Shtresa e ndërmjetme (e vetënivelueshme 1.5 deri në 3 mm)	
	Prajmer	1 × Sikafloor®-161
	Llaç nivelues	1 × Sikafloor®-161 + rërë kuarci (0,1–0,3 mm)
	Llaçi epoksid për shtrim / llaç meremetimi (trashësi shtrese 15 - 20 mm)	
	Prajmer	1–2 × Sikafloor®-161
	Urë ndërkapjeje	1 × Sikafloor®-161
	Llaç shtrimi	1 × Sikafloor®-161 + miks i përshtatshëm rëre

Këto mikse rëre janë sasitë treguese të recetës që duhet të konfirmohen me testime paraprake. Shpërndarja e përmasës së kokrrizës për trashësi 15–20 mm, pjesë për peshë (pbw): 25 pbw rërë kuarci 0,1–0,5 mm 25 pbw rërë kuarci 0,4–0,7 mm 25 pbw rërë kuarci 0,7–1,2 mm 25 pbw rërë kuarci 2–4 mm Shënim: Kokrriza më e madhe duhet të jetë max. sa 1/3 e trashësisë përfundimtare të shtresës. Në varësi të formës së kokrrizës, temperaturave të aplikimit, agregateve dhe miksit më të përshtatshëm, duhet të përzgjidhet dhe të konfirmohet me testime paraprake.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 79 : 21 (për peshë)		
Konsumimi	Sistemi i veshjes	Produkti	Konsumimi
	Prajmer	1–2 x Sikafloor®-161	1–2 × 0,35–0,55 kg/m ²
	Llaç nivelues i imët (ashpërsi shtrese < 1 mm)	1 pjesë për peshë Sikafloor®-161 + 0,5 pjesë për peshë rërë kuarci (0,1–0,3 mm)	1,7 kg/m ² /mm
	Llaç nivelues mesatar (ashpërsi shtrese deri në 2mm)	1 pjesë për peshë Sikafloor®-161 + 1 pjesë për peshë rërë kuarci (0,1–0,3 mm)	1,9 kg/m ² /mm
	Shtresa e ndërmjetme (e vetënivelueshme 1.5 deri 3mm)	1 pjesë për peshë Sikafloor®-161 + 1 pjesë për peshë rërë kuarci (0,1–0,3 mm)	1,9 kg/m ² /mm
		+ spërkatje opsionale me rërë kuarci 0,4–0,7 mm	~ 4,0 kg/m ²
	Urë lidhjeje	1–2 × Sikafloor®-161	1–2 × 0,3–0,5 kg/m ²
	Llaç epoksid shtrimi / llaç meremetimi (trashësi shtrese 15–20 mm)	1 pjesë për peshë Sikafloor®-161+8 pjesë për peshë rërë kuarci	2,2 kg/m ² /mm

Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë të kërkuar për shkak të porozitetit të sipërfaqes, profililit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.

Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max.	
Lagështia relative e ajrit	max. 80 %	
Pika e vesës	Kujdes kondensimin. Nënshtrësia dhe dyshemeja e patharë duhet të jenë të paktën 3 °C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit apo humbjes së ngjyrës. Temperaturat e ulëta dhe kushtet e lagështisë së lartë shtojnë mundësinë e humbjes së ngjyrës.	
Temperatura e nënshtrësës	+10 °C min. / +30 °C max.	
Lagështia e përmbajtjes së nënshtrësës	Përmbajtje lagështie < 6 % pjesë për peshë duke përdorur matësin Sika® Tramex (në kohën e aplikimit). Ju lutemi kini parasysh se përmbajtja e lagështisë duhet të jetë < 4 % pjesë për peshë kur përdorni matjen CM apo metodën e tharjes në furrë. Metoda e testimit: matësi Sika®-Tramex, matja CM ose metoda e tharjes në furrë. Pa lagështi në ngritje sipas ASTM (fletë polietileni).	
Koha e punueshmërisë	Temperatura	Koha
	+10 °C	~50 minuta
	+20 °C	~25 minuta
	+30 °C	~15 minuta
Koha e maturimit	Përpara aplikimit të produkteve pa tretës mbi Sikafloor®-161 lejoni:	
	Temperatura e nënshtrësës	Min. Max.
	+10 °C	24 orë 4 ditë
	+20 °C	12 orë 2 ditë
	+30 °C	8 orë 24 orë
	Përpara aplikimit të produkteve me tretës mbi Sikafloor®-161 lejoni:	
	Temperatura e nënshtrësës	Min. Max.
	+10 °C	36 orë 6 ditë
	+20 °C	24 orë 4 ditë
	+30 °C	16 orë 2 ditë
	Kohet jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.	

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtrësia me bazë çimentoje (beton / Ilaç dyshemeje) duhet të kenë strukturë të qëndrueshme, me rezistencë të mjaftueshme ndaj kompresionit (min. 25 N/mm²) dhe rezistencë minimale ndaj tërheqjes prej 1.5 N/mm². Nënshtrësia duhet të jenë të pastra, të thata dhe pa ndotje si papastërtitë, vaji, graso, veshje dhe produkte për trajtimin e sipërfaqes dhe materiale të shkrifëta. Nënshtrësia me bazë çimentoje duhet të përgatiten mekanikisht duke përdorur pastrim me rrymë abrazive ose pajisje për të hequr koren e çimentos dhe për të arritur një sipërfaqe me teksturë të hapur të përshtatshme për trashësinë e produktit. Pjesët e dala mund të hiqen me bluarje. Nënshtrësia e dobëta me bazë çimentoje duhet të hiqen dhe defektet e sipërfaqes si vrimat dhe boshllëqet duhet të ekspozohen plotësisht. Riparimet mbi nënshtrësë, mbushja e vrimave / hapësirave dhe nivelimi i sipërfaqes duhet të bëhen me anë të përdorimit të produkteve të përshtatshme nga materialet e serisë Sikafloor®, SikaDur® dhe Sikagard®. Produktet duhet të maturohen përpara aplikimit të

Sikafloor®-161. Pluhuri, materialet e lira dhe të shkrifëta duhet të hiqen plotësisht nga sipërfaqja përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë dhe/ose vakuum.

PËRZIERJA

Përpara përzierjes së të gjithë përbërësve, përzieni më vetë përbërësin A (rrëshira) me një mikser elektrik në shpejtësi të ulët (300 - 400 rpm). Shtoni përbërësin B (forcuesi) tek përbërësi A dhe përzieni vazhdimisht për 3 minuta derisa të përftohet një përzierje homogjene. Për përzierjen e përbërësve A dhe B mund të përdoret një mikser elektrik me dy akse (>700W), mikser me kovë rrotulluese ose me veprim të detyrur ose ndonjë pajisje tjetër e përshtatshme (nuk duhet të përdoren miksera me rënie të lirë). Nëse kërkohet, shtoni gradualisht granulometrinë e duhur të rërës së thatë të kuarcit dhe nëse kërkohet Extender T. Përzieni edhe për 2 minuta derisa të përftohet një përzierje homogjene. Përzierja e tepruar duhet të shmangët për të pakësuar bllokimin e ajrit. Gjatë fazës përfundimtare të përzierjes, kruani anët dhe fundin e enës së përzierjes të paktën një herë me një vegël të përshtatshme për të siguruar përzierjen e plotë. Përzieni vetëm njësi të plota. Koha e përzierjes për

A+B+rërë kuarci = 5 minuta.

APLIKIMI

Ndiqni me rigorozitet procedurat e instalimit siç përshkruhen në Method Statements, manualët e aplikimit dhe rregullat e punës, të cilat duhet të adaptohen gjithmonë sipas kushteve aktuale në kantier. Përpara aplikimit, konfirmoni përmbajtjen e lagështisë të nënshtresës, lagështinë relative dhe pikën e vesës. Nëse përmbajtja e lagështisë > 4% pjesë për pjesë, Sikafloor® EpoCem® mund të aplikohet si një sistem T.M.B (temporary moisture barrier, barrierë e përkohshme e lagështisë).

Prajmeri

Hidhni Sikafloor®-161 e përzierë mbi nënshtresën e përgatitur dhe aplikoni me furçë, rul ose shkop gome (squeegee), pastaj kaloni rulin në 2 drejtime në kënd të drejtë me njëri-tjetrin. Sigurohuni se një veshje e vazhdueshme dhe pa pore mbulon nënshtresën. Nëse nevojitet, aplikoni dy veshje me prajmer. Konfirmoni se është arritur koha e pritjes / mbiveshjes së parjmerit përpara se të aplikoni produktet vijuese. Referohuni tek skeda teknike përkatëse.

Llaçi nivelues

Aplikoni llaçin nivelues me shkop gome / shpatull në trashësinë e kërkuar.

Shtresa e ndërmjetme

Hidhni Sikafloor®-161 e përzierë mbi nënshtresën e përgatitur dhe përhapeni në mënyrë të njëtrajtshme me një shpatull krëhër. Lëvizni në dy drejtime në kënd të drejtë me njëri-tjetrin rulin me gjemba për të siguruar një trashësi të barabartë dhe nëse kërkohet spërkatni me rërë kuarci. Spërkasni midis min. ≥15 minutash, max. ≤30 minutash (në +20°C), në fillim lehtë dhe pastaj deri në ngopje.

Ura lidhëse

Hidhni Sikafloor®-161 e përzierë mbi nënshtresën e përgatitur dhe aplikoni me furçë, rul ose shkop gome. Për llaçet epokside të dysHEMEVE, kaloni rulin në drejtim vertikal dhe horizontal në kënd të drejtë me njëri-tjetrin. Sigurohuni se një veshje e vazhdueshme dhe pa pore mbulon nënshtresën. Nëse nevojitet aplikoni 2 veshje prajmeri.

Llaç epoksid për dysHEMEVE / llaç riparues

Aplikoni llaçin për riparim ose llaçin për dysHEMEVE mbi urën lidhëse që është akoma "ngjitëse". Për llaçin e dysHEMESË përdorni mastar nivelimi sipas nevojës. Pas një kohe të shkurtër pritjeje, ngjeshni dhe niveloni llaçin me një mallë. Për llaçin e dysHEMESË, rekomandohet helikopter i veshur me Teflon (20 - 90 rpm).

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Thinner C menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

- Sika® Method Statement: "VLERËSIMI & PËRGATITJA E SIPËRFAQEVE PËR SISTEMET E DYSHEMEVE".
- Sika® Method Statement: "PËRZIERJA & APLIKIMI I SISTEMEVE TË DYSHEMEVE".
- Sika® Method Statement: Regjimi i pastrimit Sikafloor®

KUFIZIME

- Pas aplikimit, Sikafloor®-161 duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi dhe kontakti i drejtpërdrejtë me ujin (shiu) uji për të paktën 24 orë.
- Fugat e ndërtimit dhe plasaritjet statike ekzistuese mbi nënshtresë duhet të trajtohen paraprakisht me një veshje në formë shiriti për mbushje dhe nivelim, e cila shërbin si izolim kundër humbjes së materialit nëpërmjet fugës apo plasaritjeve përpara aplikimit të të gjithë shtresës. Përdorni rrëshirat Sikadur® ose Sikafloor®.
- Vlerësimi dhe trajtimi i gabuar i plasaritjeve mund të çojë në reduktimin e kohëzgjatjes së funksionimit dhe plasaritje reflektive mbi sipërfaqe.
- Nëse nevojitet ngrohje e përkohshme, mos përdorni ngrohës me gaz, vajgur ose lëndë të tjera djegëse fosile, pasi këto prodhojnë sasi të mëdha avujsh CO₂ dhe H₂O, të cilët mund të ndikojnë negativisht mbi shtresë. Për ngrohje përdorni vetëm sisteme elektrike me ajër të ngrohtë.
- Mos e përdorni materialin të cilit i ka kaluar koha e rekomanduar e puneshmërisë.
- Mos aplikoni mbi nënshtresa me lagështi të rritur.
- Llaçi Sikafloor®-161 nuk është i përshtatshëm për kontakt të shpeshtë apo të përhershëm me ujin nëse nuk është izoluar më parë.
- Duhet të kryhen teste paraprake për mikset e llaçeve, në mënyrë që të vlerësohet shpërndarja e përshtatshme e madhësisë së kokrrës së agregatit.
- Për aplikime të jashtme, aplikoni vetëm gjatë rënies së temperaturës. Nëse aplikimi bëhet gjatë temperaturave në rritje mund të shfaqen disa vrima të vogla nga ajri i ngritur. Këto vrima mund të mbyllën pas një smerilizimi të lehtë duke aplikuar një shtresë fillestare Sikafloor®-161 të përzierë me ~3 % Extender T.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori produkti IIA / j lloji sb) 500 g/l (Kufizimi 2010) për produktin gati për përdorim. Përmbajtja maksimale e Sikafloor®-161 është < 500 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikafloor®-161
Gusht 2019, Botimi 05.01
020811020010000049

Sikafloor-161-sq-AL-(08-2019)-5-1.pdf